



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 060 - 24799/23
Klinë, datë: 27.07.2023

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Budisalc, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "NËNË TEREZA", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë, Stupë dhe Nagllavë. Tubimi u mbajt me datë 20 qershor 2023 dhe filloi në orën 16:00, ku morën pjesë: 17 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave, pas një përshëndetje për të gjithë të pranishmëve dhe falënderimit për pjesëmarrje, ka prezantuar në pika të shkurtra Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026. Për më shumë detaje dhe projekte infrastrukturore ai i dha fjalën kryetarit të komunës.

Kryetari Elezaj hapi diskutimin për projektet infrastrukturore, informoi banorët e zonave të lartcekura për projektet që do të realizohen sivjet e që janë ndërtimi i urës dhe i rrugëve lokale në Budisalc në vlerë prej 55 mijë euro, 120 mijë euro në ndërtimin e rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore Videjë-Krushevë 120 mijë euro si dhe zgjerimi i ndriqimit publik në fshatin Rudicë.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Halil Ahmetgjekaj – Fshati Rudicë, Kërkon projektin e ujit të pijshëm.

Rrustem Imeri – Fshati Rudicë, Kërkon të bëhen më shumë pendë për ujitje.

Halil Mehmetaj – Lokaliteti Budisalc, Kërkon kanal të ujitjes, 750 metra te shtrohet me beton.

Nue Balaj – Fshati Budisalc, Kërkon që të vendosen dy policë të vdekur në rrugë afër shkollës, sepse e konsideron që ka rrezik nga shpejtësia e lartë.



Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “NËNË TEREZA”, në fshatin Budisalc, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë, Stupë dhe Nagllavë, pjesëmarrës kanë qenë 17 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	17
Total:	17

Takimi përfundoi në orën 16:38.

Procesmbajtësi:
Nikson Daka

Klinë, datë:

